



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

MESAZH I INSPEKTORIT I PËRGJITHSHËM

Inspektorati Qendror ju siguron se “Inspektimet online do të janë sfidë e së ardhmes për më shumë efektivitet, transparencë dhe garanci ndaj biznesit të ndershëm”.

Viti 2016, ishte një vit kompleks ku sfida për kryerjen e inspektiveve online, ishte në fokus të aktivitatave të tij. Në planin e brendshëm ky vit do të përmendet përpjekjet e gjithanshme të cilat kulmuan me fillimin e inspektiveve online nga disa inspektorate shtetërore. Duke vlerësuar securinë e reformës rregullatore në fushën e inspektiveve në përgjithësi, ky vit u karakterizua nga një gjallërim i mëtejshëm, falë përpjekjeve të vazhdueshme të Inspektoratit Qendror dhe të kontributit të aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces.

Motoja jonë institucionale përgjatë këtij viti, ishte nxitja për kryerjen e inspektiveve të dixhitalizuara, sensibilizimi për kryerjen e inspektiveve online, me qëllim mbrojtjen e biznesit të ndershëm dhe goditjen e atij informal.

Veprimtaria e Inspektoratit Qendror, ka qenë jo vetëm udhëheqja metodologjike për standardizimin e dokumentacionit inspektues, hartimin dhe përditësimin e listë-verifikimeve të inspektorateve shtetërore, por dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit të inspektimit dhe ligjeve të posaçme nga inspektoratet shtetërore, duke dhënë rekomandime konkrete për përmirësimin e tyre, si dhe duke bërë evidentimin konkret të problematikave të hasura gjatë implementimit të sistemit unik të inspektimit “e-Inspektimi”.

Qëllimi ynë ndërmjet të tjera, synoi shndërrimin tonë në një burim idesh për të ndihmuar autoritetet inspektuese në implementimin dhe identifikimin e pengesave të ndryshme subjektive.

Për të mundësuar në këtë mënyrë aktivizimin e potencialeve të fjetura për inovacion dhe mëritje të qëndrueshme. Inspektorati Qendror i kushtoi një vemandje të vecantë identifikimit dhe analizimit në detaje të disa çështjeve specifike të cilat vlerësohen se kanë rëndësi sistemike.

Inspektorati Qendror, në zbatim të përgjegjësive ligjore si autoritet mbikëqyrës, synon të sigurojë efektivitetin, përgjegjshmërinë, transparencën e inspektiveve, si dhe parandalimin e fenomeneve korruptive, duke bërë dixhitalizimin e inspektiveve për t'i shndërruar ato nga një infrastrukturë fizike manuale në një infrastrukturë të dizhitalizuar. Duke pasur parasysh edhe faktin që zhvillimi i teknologjisë ecën me një shpejtësi shumë të madhe dhe në një kohë që ne sot as e përcaktojmë dhe as e përfytyrojmë dot, dhe që gjithçka të bëhet online.

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

Inspektorati Qendror është konceptuar edhe si një qendër e dixhitalizimit të inspektimeve, që do të jetë vazhdimesht në dispozicion të institucioneve inspektuese, mbikëqyrëse dhe publikut, për adresimin e problemeve për të cilat kanë nevojë për zgjidhje.

Sistemi i inspektimeve do të jetë një platformë e re ku do të kryhen absolutisht të gjitha inspektimet online, për të siguruar jo vetëm lidhjen e bazës së të dhënave në mënyrë të integruar, por të kemi një bazë të dhënash, e cila të jetë aksesibël për të gjitha ISH dhe njëkohësisht t'i japim mundësi biznesit të ketë dijeni të plotë për të gjitha aspektet që lidhen me veprimtarinë inspektuese.

Ju informojmë se përgjatë vitit 2017, edhe inspektratet vendore do të formalizohen nga ana metodologjike me përshtatjen e dokumenteve standarde dhe hartimin e listë-verifikimeve, të cilat do të implementohen në sistem, si dhe do të pajisen me paketa portabël me qëllim që vitin e ardhshëm të kryejnë inspektime online.

Në emër të Inspektoratit Qendror, dëshiroj të garantoj se veprimtaria e këtij institucioni do të jetë në fryshtë e ligjit dhe koherencë të plotë me objektivat strategjike të Inspektoratit Qendror dhe Inspektorateve Shtetërore, për të garantuar se veprimtaria inspektuese do të ketë një ndryshim rrënjosor në të ardhmen.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM

Shkëlqim HAJDARI

PËRMBAJTJA

MESAZHI I INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM

I. PËRMBLEDHJE

II. HYRJE

Qëllimi
Objektivat
Metodologjia

III. FINALIZIMI I REFORMËS NË SISTEMIN E INSPEKTIMIT

VI. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS. REZULTATET E SHQYRTIMIT.

- 1) Ministria e Punëve të Brendshme
- 2) Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- 3) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
- 4) Ministria e Arsimit dhe Sportit
- 5) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
- 6) Ministria e Shëndetësisë
- 7) Ministria e Energjisë dhe Industrisë
- 8) Ministria e Mjedisit
- 9) Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

V. KOMENTE

VI. PRAKTIKAT E MIRA

VII. MENAXHIMI FINANCIAR I INSPEKTORATIT QENDROR

VIII. REKOMANDIME

IX. KONKLUZIONE

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

I. PËRMBLEDHJE

Dixhitalizimi i inspektimeve si sfidë e së ardhmes ka vendosur standarde të reja për kryerjen e veprimtarisë inspektuese online në sistemin “e-Inspektimi”, me pritshmëri rritjen e efektivitetit, transparencës, gjurmueshmërisë, koordinimit të inspektimit, reduktim të abuzivitetit dhe kosto më të ulët administrative ndaj biznesit formal.

Përgjatë vitit 2016, Inspektorati Qendror ka përcaktuar si objektiv kryesor promovimin e inspektive online, sipas parimeve të iniciativës për një qeverisje të hapur (Open Government).

Për arritjen e objektivave, janë ndjekur politika të orientuara, me qëllim rritjen e numrit të përdoruesve të Inspektorateve Shtetërore për vënien në eficience të portalit “e-Inspektimi”, si dhe në drejtim të ngritjes së performancës së kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Inspektorati Qendror në bashkëpunim me inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese ka finalizuar përshtatjen e dokumenteve standarde dhe listë-verifikimet, për të gjitha fushat e inspektimit.

Janë implementuar në sistemin “e-Inspektimi”, dokumentet standarde dhe listë-verifikimet për Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Inspektoratin Shtetëror Shendetësor; Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve; Inspektoratin Shtetëror të Arsimit; Inspektoratin Shtetëror të Ujërave; Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial; Autoritetin Kombëtar të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; Autoritetin Kombëtar të Ushqimit; Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera.

Gjithashtu, është përbushur objktivi për komunikimin e Portalit unik “e-Inspektimi”, me platformën qeveritare të ndërveprimit.

Për vitin 2016, ka hedhur të dhëna në sistem dhe ka kryer inspektive online Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, kryesisht Dega rajonale Tiranë.

Raporti i Përgjithshëm për inspektimet në Republikën e Shqipërisë për vitin 2016, përfshin veprimtarinë e Inspektoratit Qendror, lidhur me praktikat e mira, konkluzionet, gjetjet dhe rekomandimet përmirësimin e performancës së Inspektorateve Shtetërore në të ardhmen.

Ky raport paraqet ecurinë e reformimit të fushës inspektuese lidhur me planifikimin dhe programimin e veprimtarisë inspektuese sipas metodologjisë së riskut, unifikimin e procedurës së inspektimit nëpërmjet standardizimit të dokumenteve dhe listëkontrolleve, trajnimeve përritje të performancës së inspektorëve shtetërorë.

Inspektorati Qendror ka mbikëqyrur veprimtarinë inspektuese nëpërmjet ushtrimit të kontrollit për zbatimin e ligjshmërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese në 12 Inspektorate

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

Shtetërore¹ /trupa Inspektuese dhe ka evidentuar disa mangësi dhe problematika për zbatimin e ligjit të inspektimit, si dhe të legjislacionit sektorial, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e veprimitarës inspektuese për të arritur:

- Pajtueshmërinë e zbatimit të ligeve sektoriale me ligjin e inspektimit;
- Pajtueshmërinë në respektimin e kërkesave ligjore nga ana e subjekteve inspektuese;
- Përshtatjen dhe pajtueshmërinë me dokumentacionin standard të procesit inspektues;
- Pajtueshmërinë me objektivat dhe synimet strategjike të IQ;

Inspektorati Qendror mban të përditësuar Regjistrin Kombëtar të Inspektorëve Shtetërorë dhe Vendorë në detyrë, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al, si dhe ka pajisur pothuajse të gjithë inspektorët shtetëror me kartën e inspektorit.

Ka një rritje të informimit dhe ndërgjegjsimit publik, biznesit dhe trupave inspektuese, nëpërmjet takimeve të organizuara nga IQ, me qëllim sensibilizimin e tyre për nisjen procedurave inspektuese online.

Janë pajisur të gjitha trupat inspektuese të Inspektorateve Shtetërore me paketat portabël sipas parimit 1- paketë portabël për çdo grup inspektimi.

¹ Inspektorati Shtetëror Shëndetësor,
Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore,
Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore,
Inspektorati Shtetëror i Arsimit,
Zyra e Mbrojtjes nga Rezatimet,
Reparti i Inspektimit Shpëtim Minierave,
Inspektorati Shtetëror Tëknik dhe Industrial,
Inspektorati Shtetëror i Ujërave,
Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës,
Drejtoria e Shërbimit Veterinar,
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit,
Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve

II. HYRJE

Ky Raport jep një përbledhje të rezultateve të arritura në reformimin e sistemit të inspektiveve dhe të impaktit që ajo ka në fushën e biznesit dhe mbrojtjes së konsumatorëve në Republikën e Shqipërisë, mbështetur në objektivat Strategjikë për periudhën 2014-2017, si dhe Planin Vjetor për vitin 2016.

Për implementimin e sistemit të inspektiveve dhe përdorimin e tij duhet të kapërcehet hendeku dixhital. Për këtë, politikat do të janë të orientuara drejt përmirësimit dhe zgjerimit të kapaciteteve të trupave inspektuese në mënyrë që të rritet numri i përdoruesve të këtij sistemi. Kjo infrastrukturë dixhitale do të konsolidohet për tū përdorur në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar me rigorositet parimet e legjislacionit në fushën inspektuese.

Inspektorati Qendror ka bashkëpunuar me inspektoratet shtetërore, dhe ka dhëne kontributin e tij në këto proces të modernizuar inspektimesh, si dhe ka ofruar trajnimet përkatëse për të gjithë inspektorët.

Inspektimet online do të ndihmojë institucionet inspektuese e përfshira në proces për të zvogëluar punën manuale me letra, e cila është më e ngadaltë sesa përpunimi elektronik i informacionit duke përdorur forma elektronike për komunikim me biznesin dhe publikun. Koha për përpunimin e formularëve do të reduktohet për shkak se i gjithë dokumentacioni do të jetë në format elektronik. Sistemi do të rrisë efektivitetin e inspektorëve shtetërore dhe vendor, të cilët do t'u shërbejnë më shpejt dhe më mirë biznesit dhe qytetarëve.

Qëllimi i Raportit

Përmes këtij Raporti, IQ bën të njobur aktivitetin e tij, rezultatet e arritura në fushën e inspektiveve, zbatimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor nga ana e inspektorateve shtetërore, zbatimin e procedurës inspektuese të përcaktuar, problematikën me të cilën është hasur gjatë viti raportues për implementimin e portalit të inspektiveve, standardizimin e dokumentacionit të procesit inspektues, duke dhënë edhe rekomandime në funksion të përmirësimit të efektivitetit të veprimtarisë inspektuese.

Stafi përgjegjës i IQ, për vitin 2016, reflektoi angazhimin dhe përkushtimin një vjeçar të tij në drejtim të realizimit të objektivave për të mundësuar një proces inspektues sa më efektiv dhe transparent, me qëllim përdorimin e portalit unik të inspektiveve “*e-Inspektimi*”, nga inspektoratet shtetërore.

Objektivat e Raportit

Hartimi i këtij raporti bëhet në përbushje të detyrimeve ligjore që ka Inspektorati Qendror për aktivitetin e përvitshëm të:

1. Veprimtarisë për të gjitha inspektoratet shtetërore që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Të pasqyrojë me transparencë dhe objektivitet gjetjet e konstatuara nga Inspektorati Qendror gjatë mbikëqyrjes së aktivitetit të Inspektatove Shtetërore, si dhe të sygjerojë rekomandet përmirësimin e aktivitetit të tyre.
2. Paraqitjes së këtij raporti për njohje Këshillit të Ministrave, sipas detyrimeve të ligjit të sipërpërmendur.
3. Të njoftimit të Inspektorateve Shtetërore për nevojën për të bërë ndryshimet e duhura dhe në kohë për të rritur performancën në inspekte, si dhe ndërgjegjësimin e publikut.
4. Të vodosjes së irregullave dhe standardeve të përgjithshme të raportimit të Inspektorateve Shtetërore sipas detyrimeve të ligjit të sipërpërmendur.
5. Ofrimin e inspektiveve on-line për të gjithë inspektoratet shtetërore/trupat inspektuese përmes Teknologjisë së Informacionit e Komunikimit (TIK) për qeverisjen elektronike.
6. Zbatimin e politikave e të strategjive për zhvillimin e fushave përkatëse të inspektimit.
7. Bashkërendimin e programeve në fushën e inspektiveve.
8. Nxitjen dhe promovimin e inspektiveve online.
9. Dhënien e kontributit në sensibilizimin e biznesit dhe publikut për dobitë e kryerjes së veprimtarisë inspektuese online.

Metodologjia

Metodologjia e ndjekur është ajo e raportimit në mënyrë progresive të arritjeve në sistemin e inspektimit. Për këtë u bënë analiza dhe vlerësime të dokumenteve strategjike të inspektimit, plani i veprimit për 2016, legjislacionit në fuqi për inspektimin, si dhe të gjetjeve në raportet e mbikëqyrjes së disa Inspektorateve Shtetërore të hartuara nga Inspektorati Qendror gjatë vitit 2016.

Gjithashtu, për hartimin e Raportit të Përgjithshëm vjetor të inspektimit për vitin 2016 u analizuan raportet vjetore të hartuara nga Inspektoratet Shtetërore për vitin 2016, për fushat e inspektimit që ato mbulojnë, duke bërë edhe vlerësimin e veprimtarisë së tyre.

Pas analizës së përgjithshme të sistemit, jepen edhe konluzionet dhe rekomanimet për përmirësimin e punës, rritjen e efektivitetit dhe fuqizimin e Inspektorateve Shtetërore.

III. FINALIZIMI I REFORMËS NË SISTEMIN E INSPEKTIMIT

Inspektorati Qendror, mbështetur në objektivat Strategjikë për periudhën 2014-2017 dhe Planin e tij të Veprimit 2016, ka zhvilluar aktivitete të shumta për arritjen e objektivave, për të përbushur misionin e vet atë të rritjes së efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive së inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2016, Inspektorati Qendror ka zhvilluar aktivitete që kanë synuar rritjen e performancës së inspektorateve shtetërore. Në këtë kuadër janë hartuar një sërë aktesh nënligjore, raporte mbikëqyrje, rregullore, manuale të cilat synojnë unifikimin e procedurave dhe dokumentacionin e inspektimit për të gjitha fushat dhe funksionet e inspektimit në juridikcionin e ligjit të inspektimit.

Janë trajnuar të gjitha trupat inspektuese për përdorimin e sistemit, dhe janë ritrajnuar grupe inspektorësh train of trainers. Për të asistuar teknikisht gjatë inspektimeve online janë trajnuar dhe ritrajnuar të gjithë specialistët e IT pranë Inspektorateve Shteterore.

Në vijim të reformimit të sistemit lidhur me dixhitalizimin e inspektimeve ka rritur bashkëpunimin ndërinstitucional, duke bërë edhe koordinimin e veprimtarisë së përbashkët të tyre.

✓ *Zbatimi i parimeve të ligjit për inspektimin*

Inspektorati Qendror në zbatim të parimit të proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit, si dhe pikës 7, nen 48, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" ka hartuar draft VKM për "Rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

përcaktimit të dënameve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit". Në vazhdim të zbatimit të Reformës në Inspektime, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, ky projektvendim synon të japë rregullat e përgjithshme bazë mbi metodologjinë e përcaktimit të dënameve administrative në përputhje me parimin e proporcionalitetit, gjatë procesit të inspektimit, për mbrojtjen e të drejtave të subjekteve që inspektohen, në mënyrë që dënnimi administrativ të jetë përgjithësisht i njëjtë për të njëjtën shkelje, për të shmangur rreziqet që mund t'u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë të parashikuara me ligj.

Gjithashtu, miratimi i këtij projektvendimi do të vendosë një barazi dhe transparencë në marrjen e vendimit përfundimtar nga inspektorët të cilët kanë kryer procesin e inspektimit. Kjo synon të arrijë një trajtim të njëjtë dhe të barabartë për subjektet e inspektimit për të përmirësuar performancën e inspektorëve dhe kontribuar në rritjen ekonomike të dëshiruar.

✓ *Unifikimi i metodologjisë, procedurës dhe dokumenteve të inspektimit*

- Për të përmirësuar procesin me qëllim saktësimin ligjor të procesit standard të inspektimit janë bërë ndryshime të nevojshme në rrjedhën e këtij procesi, në funksion të zbatimit korrekt të ligjit të inspektimit.
 - Për unifikimin e dokumenteve që përdoren gjatë procesit të inspektimit, në zbatim të ligjit për inspektimin dhe të Urdhrit nr. 58/1, datë 22.01.2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 58, datë 21.08.2014, "Për miratimin e formave standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë", të Inspektorit të Përgjithshëm, disa Inspektorate Shtetërore, përkatësisht: ISHA, ISHU, DPM, RISHM, ZMR, ZSHDA, ISHTI, AKBP, përshtatën ndryshimet në dokumentacionin e tyre sipas fushave specifike të inspektimit me ato unike. Theksojmë se përfundimi i këtij procesi do të bëjë të mundur dokumente unike inspektimi për të bashkërenduar veprimtaritë e Inspektorateve Shtetërore dhe kryerjen e inspektiveve të përbashkëta me qëllim që të ulet kosto administrative e subjekteve të inspektimit në lidhje me këtë aktivitet.
 - Pati edhe disa inspektorate si: AKU, RISHM, ZMR të cilat rishikuuan dhe përditësuan listë verifikimet për fushat përkatëse të inspektimit. Gjithashtu, për AKU është implementuar në Portal kategorizimi i subjekteve sipas kërkuesave specifike të ligjit të tyre sektorial.
 - Për implementimin e këtyre dokumenteve është punuar me intensitet për të hedhur të gjitha këto dokumente inspektimi dhe listë verifikimeve të rishikuara në portalin "e-Inspektimi", për ato inspektorate shtetërore që kanë përfunduar procesin e hartimit të dokumentacionit të inspektimit.
- **Hartimi dhe miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore për unifikimin e procedurave të inspektimit dhe veprimtarisë inspektuese nga inspektoratet shtetërore.**

Gjatë vitit 2016, Inspektorati Qendror ka hartuar akte nënligjore e raporte mbikëqyrëse, për unifikimin e dokumentacionit dhe procedurave inspektuese, për të realizuar unifikimin e

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

procedurës së inspektimit për të gjitha fushat dhe funksionet e inspektimit në juridikcionin e ligjit të inspektimit. Në këtë kuadër, duke synuar edhe përafrimin e legjislacionit në fushën e inspektimeve me direktivat të BE dhe harmonizimin e ligjeve sektoriale me ligjin e inspektimeve, këto nisma janë:

- a. Urdhër nr. 32/1, datë 15.07.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 32, datë 29.04.2014 "Për miratimin e modelit të kartës së inspektorit".
- b. Urdhër nr. 432, datë 28.09.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 15, datë 07.05.2015, "Për miratimin e rregullave "Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e Portalit Unik të inspektimit "e-Inspektimi".
- c. Udhëzim nr. 546, datë 04.11.2016, "Për gjenerimin e numrit unik të identifikimit për inspektorët shtetëror në detyrë në Republikën e Shqipërisë".

Gjithashtu, në zbatim të detyrave që i ngarkon ligji nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Inspektorati Qendror, ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm aktesh ligjore dhe nënligjore, të cilat i janë përcjellë për mendim, për përmirësim dhe ndryshime në legjislacionin e iniciuar nga institucione të tjera që veprojnë në fushën e inspektimit, me qëllim harmonizimin e legjislacionit drejt përafrimit me direktivat e BE, apo akteve të tjera nënligjore në mbështetje të veprimitarisë inspektuese të inspektorateve shtetërore. Këto akte ligjore dhe nënligjore të shqyrtuara janë si më poshtë:

- a. Projektligj, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", paraqitur nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
- b. Projektligj, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9634, datë 30.10.2006, "Për inspektimin e punës", paraqitur nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
- c. Projektligj, "Për rregullore detare", paraqitur nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.
- d. Projektvendim e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregulloreve mbi kontrollin shtetëror portual në Republikën e Shqipërisë", paraqitur nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.
- e. Projektligj, "Për strehimin social", paraqitur nga Ministria e Zhvillimit Urban.
- f. Projektvendim i Këshillit të Ministrave, "Masat për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organik të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime", paraqitur nga Ministria e Mjedisit.
- g. Projektvendim i Këshillit të Ministrave, "Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa bojra, llaqe dhe produkte përlustrimin e mjeteve", paraqitur nga Ministria e Mjedisit.
- h. Projektvendim, i Këshillit të Ministrave "Për rikuperimin e avuje të benzinës në fazën e II gjatë mbushjes së mjeteve motorrike në stacionet e shitjes së karburanteve", paraqitur nga Ministria e Mjedisit.
- i. Draft "Udhëzim për metodologjinë e përcaktimit të dënimive administrative në procesin e inspektimit", paraqitur nga Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimi (ZMR);

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

- j. Draft-rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, paraqitur nga Agjencia Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
- k. Draft-rregulloren e brendshme të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

Hartimi i këtyre akteve nënligjore nga Inspektorati Qendror lidhet me rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

✓ *Ushtrimi i funksionit mbikëqyrës për veprimtarinë e inspektimit*

Inspektorati Qendror, në përbushje të funksioneve të tij, ka kryer mbikëqyrjen e veprimtarisë së inspektorateve shtetërore, për zbatimin e ligjshmërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese pranë subjekteve të inspektimit, në raport me ligjin e inspektimit dhe ligjeve të tyre sektoriale.

Aktivitet mbikëqyrës është realizuar pranë 12 inspektorateve shtetërore, përkatësisht Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Inspektorati Shtetëror i Ujërave, Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimit Veterinar, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Nëpërmjet këtij aktiviteti mbikëqyrje është vlerësuar veprimtaria e inspektorateve shtetërore, ku janë identifikuar edhe problematikat e hasura, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse përmirësimin e veprimtarisë inspektuese me qëllim përmirësimin dhe unifikimin e veprimtarisë inspektuese në të gjithë sistemin e inspektimit.

Forcimi i rolit mbikëqyrës të Inspektoratit Qendror për zbatimin e ligjit të inspektimit dhe ligjeve të posaçme nga inspektoratet shtetërore për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procedimit të inspektimit, ka sjellë rritje të përgjegjshmërisë dhe efektivitetit të aktivitetit të tyre në kryerjen e detyrave që i ngarkon ligji, si dhe ka siguruar standardizimin e veprimtarisë inspektuese. Mbikëqyrja e inspektorateve shtetërore ka shërbyer edhe për identifikimin dhe përhapjen e praktikave inspektuese më të mira.

Pas mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese të këtyre inspektorateve shtetërore, Inspektorati Qendror ka dhënë edhe rekomandimet përkatëse, me qëllim përmirësimin e kësaj veprimtarie në të ardhmen, si: programi i veprimtarisë së inspektimit nga inspektoratet shtetërore duhet të ndërtohet duke u bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe në detyrimin për inspektimin periodik sipas ligjeve të posaçme, si dhe të ndjekë procedurën ligjore të miratimit nga autoritetet përgjegjëse të tyre pasi të kenë marrë më parë mendim këshillimor për bashkërendim të tyre, pranë Inspektoratit Qendror; të përdorin formatet standarde të miratuarë të veprimtarisë inspektuese; çdo nismë ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit, si dhe çdo akt administrativ i nxjerrë prej tyre, i cili ka lidhje me veprimtarinë inspektuese, duhet të këshillohet

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

më parë nga Inspektorati Qendoror; evidentimin e saktë të bazës ligjore sipas dispozitave ligjore në fuqi gjatë procesit të plotësimit të dokumentacionit në fushat përkatëse të inspektimit; organizimi i inspektorateve shtetërore sipas kërkesave të ligjit për inspektimin; hartimi i ligjeve përkatëse në ato fusha ku kjo ka dalë si domosdoshmëri, si dhe përditësimi i rregulloreve teknike; përmirësim i procedurës së regjistrimit të gjabave dhe ankimimit deri në ekzekutimin e tyre.

Regjistri Kombëtar i inspektorëve në detyrë dhe lëshimi i kartave të inspektorëve shtetërorë në detyrë.

- ✓ Në zbatim të pikës h, të nenit 16, të kreut III, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati Qendoror ka përditësuar Regjistrin Kombëtar të Inspektorëve Shtetërorë dhe Vendorë në detyrë, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendoror eee.insq.gov.al
- ✓ Mbi bazën e Urdhrit nr. 32/1, datë 15.07.2016, “Për miratimin e kartës së inspektorit” dhe Udhëzimit nr. 546, datë 04.11.2016, “Për gjenerimin e numrit unik të identifikimit për inspektorët shtetërorë në detyrë në Republikën e Shqipërisë”, janë printuar pothuajse të gjitha kartat e inspektorit dhe pajisur me të vetëm ata inspektorë që përdorin sistemin e inspektimeve online.
- ✓ ***Implementimi i Portalit unik të inspektimeve “e-Inspektimi”***

Inspektorati Qendoror ka qenë i angazhuar plotësisht për të realizuar objektivin e tij kryesor, kryerjen e inspektimeve online, duke e implementuar portalin unik të inspektimeve jo vetëm nga inspektoratet pilot, por për të bërë që ky portal të përdoret nga të gjithë inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese.

Për të arritur objektivin kryesor të inspektimve online, Inspektorati Qendoror ka ofruar pajisjen me paketa portabël, asistencë teknike dhe ri-trajnime për përdorimin e portalit unik të inspektimeve, “*e-Inspektimi*” për inspektoratet tashmë pjesë e këtij sistemi: (1) *Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)*; (2) *Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH)*; (3) *Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP)*; (4) *Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)*; (5) *Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA)*; (6) *Inspektorati Shtetëror i Ujërave (ISHU)*, (7) *Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)*; (8) *Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM)*; (9) *Reparti i Inspektimit Shpëtim Minierave (RISHM)*.

Gjithashtu, Inspektorati Qendoror ka siguruar 80 modem USB wireless për shërbimin e internetit për kryerjen e inspektimeve online për:

- ✓ 5 modem USB wireless për - ISHU ;
- ✓ 10 modem USB wireless për - ISHA ;
- ✓ 5 modem USB wireless për - ISHMP ;
- ✓ 20 modem USB wireless për - ISHPSHSH;

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

- ✓ 20 modem USB wireless për - AKU;
- ✓ 20 modem USB wireless për - ISHSH.

Ky sistem, si një qasje e re inovative ka hasur edhe në disa vështirësi të cilat kanë bërë që inspektimet online, të mos nisin brenda afateve të përcaktuara kohore për shkak të: mos njohuritë e mjaftueshme në përdorimin e kompjuterit; mungesa e kapaciteteve të burimeve njerëzore në fushën e IT, pranë inspektorateve shtetërore, si suport mbështetës për funksionimin e tij; mungesa e shërbimit të internetit (në disa vende sinjali i shërbimit të interntit është i ulët), bojës së printerit (çdo dokument i mbajtur dhe gjeneruar nga sistemi në vendin e inspektimit duhet printuar dhe dorëzuar subjektit për firmë) për kryerjen e inspektiveve online, ne terren; përmirësimi i dokemntacionit të inspektimit në sistemin “e-Inspektimi” (listat e verifikimit, pasi Inspektoratet Shtetërore nuk kanë përfshirë të gjithë bazën ligjore, kjo gjë has vështirësi në kontrollin online në terren pranë subjektit); mungesa e ndonjë subjekti të marrë nga regjistri i QKB në momentin e planifikimit të subjekteve për inspektim; integrimi me sistemin e DPT për subjektet OJF dhe Publike, si dhe për shërbimet Esig 25, Esig 27 dhe Institucionet Shtetërore dhe sistemin e DPGJC.

Ndër pritshmëritë për vitin 2017 përmendim: kryerjen e inspektiveve on-line nëpërmjet portalit “*e-Inspektimi*”, për të gjitha Inspektoratet Shtetërore në Republikën e Shqipërisë, bashkërendimin e inspektiveve, (join inspection) për kategori të ndryshme të subjekteve të inspektimit, në varësi të madhësisë së subjektit dhe rrezikut të veprimtarisë që ato kryejnë për të rritur transparencën e veprimtarisë inspektuese drejt qasjeve antikorruptive.

✓ *Platforma Qeveritare e Ndërveprimit*

Platforma qeveritare e ndërveprimit është një platformë kyçë e realizimit të ndërveprimit të sistemeve të institucioneve të Administratës Publike. Ajo është në zhvillim të vazhdueshëm, meqenëse edhe kërkesat për ndërveprim mes sistemeve mriten gjithmonë e më shumë.

Në kuadër të këtij projekti të ndëmarrë nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Inspektorati Qendror ka finalizuar ndërveprimin me sistemin e QKB-së.

Është në proces ndërveprimi sistemi “*e-Inspektimi*” me sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe sistemin e Gjendjes Civile (DPGJC).

✓ *Vlerësimi dhe testimi i inspektorëve shtetëror*

Lidhur me kualifikimin dhe testimin e inspektorëve, detyrim ligjor që rrjedh në zbatim të nenit 21, të ligjit për inspektimin, akoma në këtë drejtim ekziston një ngërç me Departamentin e Administratës Publike, si rrjedhojë e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, për hartimin dhe miratimin e rregullores për intervalet e testimit periodik të inspektorëve, rregullat e hollësishme për procedurën e provimit dhe kriteret përkatëse të vlerësimit në këtë procedurë. Kjo rregullore propozohet në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, duke plotësuar kuadrin ligjor lidhur me testimin e inspektorëve shtetërorë.

RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS. REZULTATET E SHQYRTIMIT

1. Ministria e Punëve të Brendshme

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), nuk ka paraqitur raportin vjetor për vitin 2016 dhe në zbatim të ligjit për inspektimin nuk ka përbushur detyrimin ligjor të raportimit pranë Inspektoratit Qendror².

2. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor (DIH), ngarkohet për kontrollin e zbatimit të dispozitave të këtij Kodi. Kjo Drejtori ka për detyrë kontrollin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore dhe garantimin e zbatimit të rregullave për:

- a) mbrojtjen, mirëmbajtjen, remontin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës hekurudhore;
- b) lëvizjen e sigurt të trenave;
- c) kontrollin teknik të mjeteve lëvizëse gjatë shfrytëzimit të tyre;
- ç) të gjitha procedurat e ndjekura gjatë pranimit për shfrytëzim të mjeteve hekurudhore.

Sistemi hekurudhor shqiptar këtë vit pati ndryshim shumë të rëndësishëm në legjislacon me miratimin e Ligjit Nr. 146/2016, datë 23.12.2016, “Kodin Hekurudhor”.

✓ *Inspektimi i mjeteve lëvizëse*

Gjatë vitit 2016 janë ushtruar kontolle të vazhdueshme lidhur me gjëndjen teknike të mjeteve hekurudhore, si dhe në Njësinë e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse për zbatimin e grafikut te riparimeve të lokomotivave, vagonave udhëtarë dhe të mallit duke duke i kushtuar vëmendje cilësisë së riparimit të tyre. Kontrollet janë realizuar nga specialistë dhe ndihmësinspektorët e të dy sektorëve me një rritëm kontrolli po thuaj të njëjtë gjatë gjithë vitit me një mesatare afersisht 60 kontolle në muaj.

Nga kontrollet e kryera për gjendjen teknike të lokomotivave rezultojnë se ato jane të rregulla për qarkullim. Sistemi i frenimit është efikas dhe aparatet e regjistrimit të shpejtësisë të lëvizjes së lokomotivave funksionojnë normalisht. Në qarkullim janë kontrolluar aparatet dhe shiritat e regjistrimit të shpejtësisë në 108 trena malli e udhëtarë. Pas kontolleve janë bllokuar 8 lokomotiva për mos regjistrim të rregullt në shiritin e aparatit të matësit të shpejtësisë. Shiritat e regjistrimit të shpejtësisë janë kontrolluar në 25 rastet e avarive e të aksidenteve hekurudhore të ndodhur gjatë vitit 2016.

² Neni 16, pika e) e ligjit 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH” dhe Seksioni IX, pika 3 e VKM nr. 696, datë 16.8.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përbajtjen dhe administrimin e portalit “e-inspektimi”.

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

Gjithashtu, gjatë kontolleve të ushtruara në stacionet e udhëtarëve fundore e tranzite janë bllokuar për mangësi teknike kryesishët për mos rendiment frenimi 3 vagona udhëtarë.

✓ *Inspektimi i vijës hekurudhore*

Por, nga inspektimet e ushtruara gjatë vitit 2016 në të gjithë vijën hekurudhore konstatohet se gjendja teknike e vijës hekurudhore vazhdon të mbetet e dobët, pa shënja përmirësimi krahasuar me vitin 2015.

Megjithatë, në lidhje me veprat e artit ashtu si dhe traseja me gjëndjen e tyre aktuale në përgjithësi nuk kompromentojnë mundësinë për ndërprerje të aktivitetit të trafikut hekurudhor.

Si pasojë e inspektimeve gjatë vitit 2016 është ulur numri i aksidenteve nga 21 aksidente në vitin 2015 në 11 në vitin 2016. Po kështu edhe numri i avarive hekurudhore është ulur nga 21 në 14 të tillë.

Këto rezultate tregojnë një përmirësim të shërbimit të hekurudhave si pasojë e veprimtarisë inspektuese.

3. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) dhe Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), përgjatë vitit 2016 janë shkrirë në një trupë të vetme inspektuese me Vkm nr. 36, datë 20.01.2016, “Për krijimin e organizmin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, por ky inspektorat është akoma në procesin e organizimit të tij.

Inspektoratit Shtetëror Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), është struktura përgjegjese për inspektimin e zbatimit e kërkësave ligjore: (1) për fushën e mbrojtjes së konsumatorëve; (2) mbrojtjes së pronësisë industriale; (3) mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to; (4) metrologjik (fushën e metrologjisë); (5) etiketimi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera produktin me ndikim në energji; (6) kontrollin e detergjentëve; (7) kontrollin e veprimtarive turistike.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit

Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), në zbatim të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, siguron përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar, si dhe inspektimin e zbatimit të kërkësave ligjore në arsimin parauniversitar dhe në zbatim të planit vjetor 2016, ka kontrolluar pajtueshmërinë e veprimtarive të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe ka monitoruar, vlerësuar dhe ka nxjerrjë përfundime duke dhënë këshillime për zhvillimin e arsimit parauniversitar.

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

Lidhur me aktivitetin inspektues gjatë vitit 2016, ISHA ka realizuar:

- ✓ **20 inspektime të plota** me qëllim vlerësimin e cilësisë së ofruar nga institucionet arsimore.
- ✓ **57 inspektime tematike** për vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar në kuadër të funksionimit të shërbimit psikologjik, Komisionit të Disiplinës dhe Komisionit të Etikës e sjelljes, me qëllim parandalimin dhe eliminimin e çdo forme dhune në shkollë; për vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar në: menaxhimin e shkollës, në lidhje me planifikimin e zhvillimit të shkollës, planin e vëzhgimeve të orëve mësimore dhe monitorimit të dokumentacionit shkollor, vetëvlerësimin, si dhe zhvillimin profesional të stafit mësimor; vlerësimin e arritjeve të nxënësve për kurrikulën me kompetenca, me qëllim mbështetjen e të nxënët dhe përparimin e nxënësve;
- ✓ **131 inspektime të orientuara** për “Vlerësimin e performancës së drejtuesve të shkollave”; vlerësimin e realizimit të rekomandimeve të lëna; me qëllim vlerësimin e zbatimit të kritereve të ligjshmërisë në plotësimin e dokumentacionit shkollor në institucionet arsimore private, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore;
- ✓ **236 monitorime lidhur me:**
 1. identifikimin e nevojave për zhvillimin profesional të punonjësve mësimor në sistemin arsimor parauniversitar”.
 2. monitorimin e olimpiadave kombëtare të matematikës, fizikës, biologjisë, kimisë, informatikës dhe gjuhë shqipe dhe letërsisë.
 3. provimin e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.
 4. monitorimin e testimit paraprak të maturantëve në 13 DAR-e.
 5. vlerësimin e arritjeve të nxënësve të klasave të V-ta në 13 DAR-e.
 6. zhvillimin e provimit të Maturës Shtetërore 2016 (sesioni i I-rë dhe II-të).
 7. zhvillimin e Provimeve të Lirimt 2016 (sesioni i I-rë dhe II-të).
 8. zbatimin e procedurave të regjistrimit të nxënësve në klasat e X dhe procesit të shitjes dhe shpërndarjes së teksteve shkollore.

ISHA ka shqyrtuar 95 raste të ankimeve, nga të cilat 33 raste janë trajtuar nëpërmjet inspektive të drejtpërdrejta në terren dhe 62 raste nëpërmjet komunikimit me DAR/ZA-të dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar nga ana e tyre. Për zgjidhjen e ankimeve janë bërë inspektive lidhur me verifikimin e problemeve të ngritura.

Nga mbikëqyrja e realizuar gjatë vitit 2016, pranë Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, nga Inspektorati Qendror, u kanstatua se procedura inspektuese, kryhet rregullisht në përputhje të plotë me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

ISHA, gjithashtu ka finalizuar përshtatjen e formave standarde të inspektimit dhe listë-verifikimet dhe i përdor këto dokumente për dokumentimin e veprimitarisë inspektuese, në

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

formën hard-copy. Gjatë vitit 2016, trupa inspektuese e ISHA-së është trajnuar nga Inspektorati Qendoror lidhur me sistemin unik “e-Inspektimi” dhe është pajisur me 14 paketa portabel, por në fillim të vitit 2017 ISHA ka realizuar procedurën inspektuese on-line nëpërmjet portalit “e-Inspektimi”.

5. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, (ISHPSHSH), është një faktor i rëndësishëm i tregut të punës, duke kontribuar ndjeshëm në rritjen e nivelit të zbatueshmërisë së Legjislacionit të Punës, për sigurimin e zbatimit për kushte pune të denja, për mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për ligjshmëri në zbatimin e kohëzgjatjes së punës, për pagesën për punë të kryer konform legjislacionit, për sigurimin e çdo punëmarrësi, higjenën dhe mirëqenien në vendin e punës, për punësimin e ligjshëm të fëmijëve, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me marrëdhënien e punës.

Janë inspektuar gjithsej 11.299 subjekte private dhe shtetërore, duke bërë një punë kryesishët këshilluese, ndërgjegjësuese dhe të njohjes me legjislacionin e punës, e cila ka ndikuar drejtpërsëdrejti edhe në luftën kundër informalitetit, duke rritur me 3% numrin e punëmarrësve që sigurohen me pagë reale e jo minimale.

Janë rritur me 3% më shumë se një vit më parë inspektimet e planifikuara, ku orientimi drejt inspektimeve të mirë-planifikuara, ka ndikuar drejtpërdrejtë në uljen e inspektimeve për rast aksidenti apo dhe në uljen e inspektimeve për shkak ankesës.

Gjatë vitit 2016 ka 31 punëmarrës më pak të aksidentuar, me 0.7% më pak inspektime për raste aksidenti në punë, krahasuar me vitin paraardhës.

ISHPSHSH, ka legalizuar punën për 1200 punëmarrës më shumë se një vit më parë, duke i përfshirë ato në skemën e sigurimeve shoqërore duke ndikuar drejtpërdrejtë si në mbrojtjen shoqërore e shëndëtsore të tyre, ashtu dhe në buxhetin e shtetit.

Numri i subjekteve të sankcionuara gjatë vitit 2016 është 117, nga këto 74 gjoba në inspektimet e Planifikuara, 27 gjoba në inspektimet për shkak Ankesë, 16 gjoba në inspektimet për shkak Aksidenti.

Kontrolli i aktiviteteve të hoteleri-turizmit si prioritet i periudhës Korrik – Gusht 2016, ka patur arritje krahasuar me një vit më parë dhe si rezultat i këtyre inspektimeve, janë futur në skemën e sigurimeve shoqërorë dhe shëndëtsore 468 punonjës, duke rritur punësimin formal.

Ka patur një rritje të konsiderueshme të numrit të subjekteve që përdorin paisje mbrojtëse kolektive dhe individuale, kjo si pasojë e rritjes së numrit të inspektimeve në subjektet që paraqesin rrezikshmëri për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve, si dhe takimeve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese me biznesin në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës, e në veçanti për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive, me qëllim uljen e numrit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

Janë përdorues të portalit të inspektimeve “e Inspektimi” dhe kryesishet dega rajonale Tiranë, e cila ka punuar edhe në dokumentacion të shtypur edhe në portal gjatë gjithë vitit 2016.

Ndërkojë degët e tjera rajonale punën në portal paraleshit me dokumentacionin e shtypur e kanë filluar nga muaji nëntor 2016.

Është bërë në mënyrë të vazhdueshme monitorimi i punës për Drejtoritë Rajonale të ISHPSHSH-së në lidhje me procedurën e hetimit të aksidenteve në punë, është hartuar Manuali “Për Hetimin e Aksidenteve në Punë”, si dhe është hartuar manuali i vlerësimit të riskut.

Në fushën e Shërbimeve Shoqërore janë inspektuar 127 qendra shërbimi publike dhe jopublike ose rrëth 72% e tyre. Qendrat e inspektuara prekin të gjithë tipologjitë e shërbimeve, rezidenciale, ditore, multidisiplinare, ku përfshihen edhe 6 vlerësime të standarteve për qendrat e reja që janë krijuar.

6. Ministria e Shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë, në fushën e juridikcionit që mbulon përfshin tre fusha inspektimi si më poshtë:

6.1 Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, (ISHSH) ushtron veprimtarinë e tij bazuar në VKM nr. 241, datë 27.03.2013, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor” dhe siguron respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik dhe rritjen e cilësisë së dhënies së shërbimeve të shëndetëshme ndaj popullatës.

Gjatë vitit 2016, ka realizuar gjithsej 44 407 inspektime në të gjithë vendin dhe nga këto inspektime janë marrë 529 masa administrative. Në krahasim nga viti 2015, në rang kombëtar, kemi një rritje prej 62% të numrit të inspektimeve dhe një rritje të masave administrative të marra prej 7%.

Këto 44 407 inspektime janë kryer sipas fushave inspekuese që ISHSH mbulon, si më poshtë:

- ✓ *404 inspektime spitalore* pranë qendrave spitalore universitare dhe spitaleve publike dhe jopublike, dhe janë marrë 5 masa administrative me pezullim të përkohshëm aktiviteti;
- ✓ *6 inspektime të shërbimit të hemodializës* në institucionet shëndetësore që kryejnë këtë shërbim, ku dhe janë marrë 4 masa administrative;
- ✓ *1 662 inspektime stomatologjike* për subjektet kabinet, klinikë, laborator dentar dhe janë marrë 38 masa administrative me pezullim të përkohshëm të aktivitetit me qëllim përmirësimin e kushteve;
- ✓ *1 162 inspektime ambulatore* për subjektet kabinet, klinikë dhe laboratorë mjekësor, ku dhe ka përmbrushje të detyrave brenda afateve;

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

- ✓ 514 inspektime për mbetjet spitalore për institucionet prodhues të mbetjeve spitalore, në instalacionet prodhues të mbetjeve spitalore dhe në stabilimentet e trajtimit të mbetjeve të rrekzishme;
- ✓ 12 966 inspektime sanitare përpara dhe gjatë sezonit turistik, pranë subjekteve të prodhimit, ruajtjes, magazinimit dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore dhe pijeve alkoolike dhe jo alkoolike me destinacion konsumin human, ku dhe janë marrë 97 masa administrative;
- ✓ 2 810 inspektime higjeno-sanitare në institucionet arsimore publike dhe jopublike parashkollore, në institucione arsimore shkollore, në institucione të arsimit të lartë dhë në konvikte dhe menca në funksion të tyre, si dhe janë marrë 4 masa administrative dhe 18 vendime të ndërmjetme;
- ✓ 889 inspektime për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- ✓ 8 inspektime për zbatimin e ligjit nr. 8528, datë 23.09.1999, “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gjji”, të ndryshuar, ku dhe janë marrë 4 masa administrative;
- ✓ 19 454 inspektime për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit dhe janë marrë 340 masa administrative;
- ✓ 18 inspektime të institucioneve të ekzekutimit të dënimive penale dhe paraburgimit;
- ✓ 72 inspektime në subjektet që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese dhe janë marrë 14 masa administrative;

Nga mbikëqyrja e realizuar gjatë vitit 2016, pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, nga Inspektorati Qendror, u kanstatua se procedura inspektuese, përgjithësisht, realizohet konform ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Procedura inspektuese për kujdesin spitalor pranë Qendrave Spitalore Universitare, nuk realizohet sipas ligjit për inspektimin. Realizimi i inspektiveve kryehet bazuar në Programin Vjetor të inspektiveve, i cili është hartuar në bazë prioritetesh dhe kategorish subjektesh të ndara sipas këtyre prioriteve.

ISHSH, gjithashtu ka finalizuar përshtatjen e formave standarde të inspektimit dhe listë-verifikimet për dokumentimin e veprimtarisë inspektuese, por gjatë vitit 2016, këto forme nuk kanë gjetur përdorim në formën hard-copy gjatë veprimtarisë inspektuese.

Baza ligjore në kompetencë të ISHSH-së ka nevojë për rishikim, duke bërë të mundur përcaktimin e saktë të juridiksonit të saj në fushën e inspektiveve. Ligjet sektoriale të ISHSH-së mbivendosen kryesisht me ligjet sektoriale të ISHPSHSH-së, AKU-së dhe ZMR-së.

6.2 Agjensia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), vepron në zbatim të ligjit nr. 105/2014, datë 31.07.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, si dhe VKM nr. 24, datë 14.01.2015, “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”.

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

AKBPM kryen rregullisht inspektime për barnat pranë subjekteve farmaceutike që kanë të bëjnë me vendosjen në treg, tregtimin me shumicë dhe pakicë, kushtet e ruajtjes së barnave, lëndëve të para dhe ndihmëse e materialeve ambalazhuese, tregtimin dhe eksporimin e barnave të produara nga fabrikuesit vendas, importin e barnave, autorizimin për import, por nuk ka kryer asnjë inspektim për pajisjet mjekësore.

Gjatë veprimtarisë së saj inspektuese, ka inspektuar:

- ✓ 635 subjekte farmaceutike (depo farmaceutike, farmaci, agjenci farmaceutike).
- ✓ 2035 raste për barnat të importuara dhe barna të produara në vend.

Janë marrë 65- masa administrative nga këto:

- a) Farmaci: 47- raste dënim me gjobë dhe 29 raste sekuestrim/konfiskim i barnave;
- b) Agjenci farmaceutike: 7 raste me dënim gjobë dhe në 4-raste sekuestrim/konfiskim i barnave;
- c) Depo farmaceutike: 11-raste me dënim me gjobë.

Gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë së saj inspektuese për 2016 u konstatua se:

- ✓ AKBPM ka hasur problematika lidhur me identifikimin e adresave të subjekteve farmaceutike, dhe është sygjeruar nga ana jonë që AKBPM, të jetë autoriteti përgjegjës, i cili duhet të kryejë vlerësimin paraprak të subjekteve farmaceutike para licencimit, për plotësimin ose jo të kërkesave ligjore nga ana e subjekteve licencues.
- ✓ Preparatet “Integratori” që tregtohen në subjektet farmaceutike nuk kontrollohen nga AKBPM apo AKU, pasi nuk janë target i ligjeve të tyre sektoriale.
- ✓ Nuk ka perfunduar akoma paketa e akteve administrative nënligjore që rrjedhin nga ligji i barnave dhe pajisjeve mjekësore.
- ✓ Nuk ka kryer inspektimi pranë farmacive spitalore shtetërore dhe spitalore private.
- ✓ Nuk kryen inspektimi për pajisjet mjekësore, por është në procesin e regjistrimit të tyre dhe brenda këtij viti, duhet të mbarojë regjistri kombëtar i këtyre pajisjeve.

AKBPM, ka finalizuar përshtatjen e formave standarde të inspektimit dhe listë-verifikimet për dokumentimin e veprimtarisë inspektuese dhe janë implementuar në portalin e inspektimeve, por nuk janë akoma përdorues të këtij portali.

6.3 Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR) vepron në zbatim të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jo jonizuese”, dhe ka mision kryesor përcaktimin e kushteve të mbrojtjes dhe të sigurisë nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve, të popullatës dhe mjedisit, në tërësi, nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve, si dhe sigurimin e materialeve radioaktive, duke shfrytëzuar, në maksimum të mirat që vijnë nga përdorimi i rrezatimeve jonizuese, si dhe monitorimin e rrezatimeve jojonizuese.

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

Në zbatim të funksioneve që japid ligjet për mbrojtjen nga rrezatimet jojonuese dhe jojonizuese, dhe misionit të saj, ZMR përgatit dokumentet ligjore për mbrojtjen e punonjësve, publikut dhe mjedisit nga efektet e rrezatimeve.

Në bazë të planit të inspektimeve për vitin 2016, janë realizuar të gjitha inspektimet e planifikuara. Gjatë vitit 2016, janë realizuar inspektime në subjektet e licencuara, si kabinetet e radiologjisë shtetërore dhe private që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X, si dhe në ato qendra ku aplikohet me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive. Janë realizuar matje në lidhje me fuqinë e dozës, në ambientet publike dhe në ato ambiente ku stafi është i angazhuar në punë me burime të rrezatimit jojonues. Gjithashtu, janë kryer 45 inspektime dhe nuk është marrë asnjë vendim me gjobë, pasi në asnjë rast nuk është hasur gjatë inspektimit shkelje të dispozitave ligjore. ZMR ka realizuar 10 Inspektime në institucione shtetërore ndërsa 35 inspektime janë realizuar pranë subjekteve private.

Gjatë punës së saj, ZMR ka pasur disa arritje pasi formalisht procedura e inspektimit është respektuar, ndër të tjera mund të veçojmë njoftimin e subjekteve që do të inspektohen brenda afateve të përcaktuara me ligj si dhe përmirësimi i dokumentacionit të veprimtarisë inspektuese duke e sjellë këtë dokumentacion më afér kërkesave të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Përgjatë vitit 2016, është identifikuar një objekt i ri pune i cili është inspektimi i mjeteve që transportojnë burime jojonuese.

ZMR, ka shfaqur edhe disa problematika ku si më kryesoren do të cilësonim moskryerjen e asnjë procedure inspektuese për sa i përket rrezatimit jojonizues sipas përcakttimeve të ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese". Kjo sjell nevojnë e fuqizimit me mjetet e duhura teknike për të bërë inspektimin në këtë fushë lidhur me burimeve jojonizuese.

7. Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në fushën e juridikzonit që mbulon përfshin dy inspektoratë shtetërore, si më poshtë:

7.1 Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), është struktura përgjegjëse për inspektimin dhe përbushjen e detyrave e kërkesave ligjore në fushën e mëposhtme:

- ✓ përpunimit, transportimit e tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre;
- ✓ sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion;
- ✓ sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike;
- ✓ sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror;
- ✓ sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë joushqimore brenda fushës së përgjegjësisë të ministrisë përgjegjëse për industrinë;

Inspektimi i Naftës e Gazit

Drejtoria e Inspektimit të naftës dhe Gazit ushtroi kontroll mbi personat juridikë që ushtrojnë veprimtari të përpunimit, sipas programit vjetor "Për veprimtarinë e DING për vitin 2016", Inspektime për kontrollet cilësore për respektimin e standardeve teknike të Naftës dhe Nënprodukteve. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016, janë ushtruar inspektimet në sha dhe shpk në zbatim të ligjit nr. 10433 datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqiperisë", dhe në zbatim të detyrave të ngarkuara sipas ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, për: Kontrollin e zbatimit të kushteve të parashikuara në Licencat apo Autorizimet qe u janë dhënë personave juridikë në Instalimet e impjanteve dhe pajisjeve përkatëse nga personat juridikë që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat ligjore.

Kontrollin e respektimit të standardeve për cilësinë e Naftës dhe Nënproduktet e saj. Në vitin 2016 janë kryer 8343 inspektime, nga të cilat janë kryer 1809 inspektime në sha dhe 4397 inspektime në shpk, në krahasim me 7827 inspektime që janë kryer në vitin 2015.

Për rastet kur nga kontrollet cilësore janë konstatuar subjekte që tregojnë produkte me shmangje të treguesve cilësor dhe subjektet që kanë patur mangësi me dokumentacionin tekniko – ligjorështë vepruar me sanksione me dënlime administrative, gjobë.

Në vitin 2015 janë vendosur sanksione në 271 raste, ndërsa në vitin 2016 janë vendosur sanksione në 257 raste, nga të cilat 33 gjoba për Sha dhe 224 për Shpk.

Në këtë kuadër, një pjesë e subjekteve i janë drejtuar ISHTI-t për mbyllje ose kufizim të veprimtarisë, disa subjekte të tjera nuk plotësojnë ose kanë humbur kushtin e kapacitetit depozitives për të cilat janë licencuar, si dhe i është propozuar MEI për heqje licence për 18 shoqëri dhe heqje të kategorive të produkteve në licencat e tregtimit për 13 shoqëri.

Gjatë veprimtarisë inspektuese të vitit 2016 janë marrë gjithsej 7471 mostra për kontroll cilësor nga 6041 mostra të marra një vit më parë.

Inspektimi i Pajisjeve Nën Presion

Ky funksion inspektues kryhet nga D.I.N.G specializuar për kontrollin e veprimtarisë në fushën e projektimit, prodhimit, montimit dhe shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion, pjesë përbërëse e I.S.H.T.I., që inspekton, si më poshtë :

- ✓ Zbatimin e detyrimit të operatorëve ekonomikë, që pajisjet/instalimet nën presion, t'i nënshtronen vlerësimit të konformitetit nga një organ i miratuar/notifikuar;

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

- ✓ vlerësimi i aktivitetit të operatorëve ekonomikë privatë ose entet publike që ushtrojnë veprimitari me pajisje/instalime nën presion në përputhje me kërkesat ligjore për dokumentacionin e duhur, zbatimin e kushteve e normave teknike, etj.

Ky funksion inspektues mbulohet nga 15 inspektorë në të gjithë territorin e RSH nga 15 inspektorë, të organizuar në 3 Sektor sipas ndarjes territoriale.

Në bazë të planifikimit vjetor për vitin 2016 kanë qënë për të kryer 1 262 inspektimi në subjekte dhe 2 787 inspektimi në paisje nën presion të ndarë sipas tre Sektorëve, në fakt inspektimet e kryera në 1542 subjekte dhe 3523 paisje nën presion sipas sektorëve.

Gjatë vitit 2016 janë mbajtur 46 Akt Konstatimi për paisje/instalime nën presion të cilat nuk garantonin sigurinë teknike në shfrytëzim. Nga këto, Komisioni i Ankimimit të masave administrative pranë I.SH.T.I., pas shqyrtimit të dokumentacionit të mbajtur nga inspektorët, ka vënë sanksione për subjekte duke vendosur masën e gjobës në 28 subjekte inspektimi.

Si pasojë është bërë e mundur plotësimi i dokumentacionit teknik e ligjor nga ana e tyre edhe me Aktin e Miratimit të Projektit Teknologjik. Por aksidente në ambiente në të cilat përdoren bombola me GLN, tregojnë se sa e rëndësishme është garancia teknike e tyre dhe mënyra e shfrytëzimit.

Inspektimit të Pajisjeve e Instalimeve Elektrike

Realizimi i detyrate të programuara të punës të DIPNP- së i referohet ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, i ndryshuar, “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike” (Ligj sektorial për funksionimin e D.I.P.I.E.-së) dhe ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë këtij viti kanë ndodhur gjithsej 25 aksidente, në numër dy më shumë se vitin e kaluar. Në vazhdim po bëjmë një klasifikim të këtyre aksidenteve të ndodhura gjatë këtij viti, pasi nuk kanë marrë siç duhet masat e domosdoshme tekniko-organizative të parrezikshmërisë, si dhe shkelja e rregullave të sigurimit teknik.

Në mënyrë të përbledhur shkaqet e aksidenteve janë si më poshtë:

- Mos zbatimi i procedurave të punimit.
- Linja elektrike në të cilat janë cënuar parametrat teknik.
- Ndërhyrje të paligjshme në rrjetin elektrik për punime ose dëmtime.

Per vitin 2016 janë realizuar 1224 inspektimi dhe problematikat e trajtuara janë :

1. Zbatimi i ligjit nr. 10489, dt 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”.
2. Zbatimi i VKM nr.245, datë, 30.03.2016, “Për paisjen e instalimeve elektrike me dispozitiv diferencial.
3. Verifikimi i dëshmisë së aftësisë për punonjësit elektrike, në zbatim të Rregullores së Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike.

Për 59 subjekte janë realizuar detyrat e lëna , 1 subjekt është gjobitur për mosrealizim detyrash 30 subjekte janë në proces për verifikim realizim detyrash. Gjithashtu, është në proces një program kontrolli në kopshte, çerdhe dhe shkolla në gjithë teritorin e vendit, ku janë inspektuar rreth 140 objekte (kopshte, çerdhe dhe shkolla). Propozimet për gjoba për vitin 2016 janë për 19 subjekte inspektimi.

7.2 Reparti Inspektim Shpëtim Miniera (RISHM), vepron në bazë të ligjit nr. 8741, datë 15.02.2001, “Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Veprimitaria e drejtorisë së inspektimeve për vitin 2016, si njësi përgjegjëse në RISHM është përqendruar për realizimin e kontrolleve teknike në miniera, në vlerësimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve.

Gjatë vitit 2016 janë kryer 833 inspektime të programuara pranë subjekteve që ushtrojnë veprimitari minerare. Është bërë e mundur respektimi i frekuencës së përcaktuar me ligj, ku përcaktohet se subjektet që ushtrojnë veprimitari në miniera nëntokësore me rregjim gazi (në total 4) të inspektohen jo më pak se 3 herë në vit, subjektet që ushtrojnë veprimitari në miniera nëntokësore pa rregjim gazi të inspektohen të paktën 2 herë në vit dhe minierat sipërfaqësore dhe fabrikat e pasurimit të inspektohen të paktën një herë në vit. 13 inspektime kanë qenë të pa planifikuara, ku 8 inspektime janë realizuar për shkak të aksidenteve dhe 5 inspektime janë realizuar si të posaçme. Vlen të theksohet se viti 2016 ka qenë viti me aksidente me të ulëta përsa i përket pasojave për jetën dhe shëndetin e punonjësve të minierave.

Për sa përket vitit 2016 aktiviteti i minierave për shfrytëzimin e hekur-nikelit dhe bakrit ka qenë i ndërprerë, por janë inspektuar për kontrollin e masave të marra për problemet e sigurisë gjatë kohës që nuk kryejnë aktivitet.

Në përgjithësi, fokusi i inspektimeve është orientuar drejt realizimit të projekteve faktike ose projekteve të zbatimit për çdo vend pune si dhe dokumentimi i veprimitarisë së punës në miniera nëpërmjet urdhra pune, udhëzime teknike, projekte, pasaporta në përputhje me situatën teknike dhe minerare. Për sa i përket masave administrative, janë marrë 23 masa administrative kryesore (paralajmërim), 1 ndalesë pune dhe 1 masë administrative propozim për revokim leje minerare.

Në vitin 2016, ka hyrë në fuqi ligji nr. 135/2016, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimitarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8741, datë 15.2.2001, “Për sigurinë në punë në veprimitarinë minerare” dhe ka përcaktuar si organ përgjegjës për inspektimeve të këtë fushë Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM).

Gjatë veprimitarisë inspektuese të këtij Institucioni janë vërejtur disa mangësi si vijon: Në rastet e inspektimeve që nuk ushtronin veprimitari minerare nuk kishte të bashkëlidhur asnjë dokument tjetër përveç autorizimit, duke mos plotësuar formatet e tjera të dokumenteve të inspektimeve, si procesverbal apo vendime etj. Subjekteve të inspektimeve i lihej detyra për të realizuar, por nuk liheshin afate. Organi i cili do të shqyronte ankimin kishte në përbërje punonjës së sektorit të

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

inspektimeve, për shtatë mëjorin e parë të vitit nuk është bërë asnjë ankesë në lidhje me dënimet administrative.

8. Ministria e Mjedisit

8.1. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP), nuk ka paraqitur raportin vjetor për vitin 2016 dhe në zbatim të ligjit për inspektimin nuk ka përbushur detyrimin ligjor të raportimit pranë Inspektoratit Qendror³.

IQ ka mbikqyr veprimtarinë inspekturese të tij ku u vërejt se ka patur rezultate pozitive në inspektimet e ushtruara në bazë të task forcës për zbatimit e ligjit për pyjet pranë bashkive/komunave, të qarkut Tiranë.

Për zbatimin e procedimit administrativ për inspektimin u konsatua se nuk ka gjetur zbatim ligji per inspektimin dhe konkretisht:

1. Programet vjetore të inspektimit, hartohen mbi bazë tematike pa u mbështetur në një metodologji të mirëfilltë të vlerësimit të riskut dhe nuk janë të miratuara nga autoritet përgjegjëse.
2. Programet mujore të inspektimit nuk përgatiten mbi bazë të subjekteve të inspektimit.
3. Brenda të njëjtë institucion ndiqen procedura inspektimi të ndryshme për dy funksionet e inspektimit që mbulon ky inspektorat.
4. Gjatë kryerjes së veprimtarisë inspekturese përdoren formatet standarde të inspektimit, por ka mangësira në plotësimin e tyre.
5. Nismat ligjore për veprimtarinë inspekturese nuk kanë marrë mendim këshillimor nga Inspektorati Qendror.
6. Nuk ka miratuar ende irregulloren e brendshme të inspektimit.
7. Janë pajisur me 62-paketa portabël, por ato nuk u janë shpërndarë inspektorëve të mjedisit, por nëpunësve të tjera jashtë detyrave inspekturese.
8. Megjithë angazhimet e IQ, për kryerjen e inspektiveve nëpërmjet paketave portabël si inspektorat pilot, akoma nuk janë përdorues të portalit “e-Inspektimi”.

³ Neni 16, pika e) e ligjit 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH” dhe Seksioni IX, pika 3 e VKM nr. 696, datë 16.8.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përbajtjen dhe administrimin e portalit “e-inspektimi”.

9. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ka në fushën e juridiksimit që mbalon dy inspektorate shtetërore dhe dy trupa inspektuese, si më poshtë:

9.1 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), në zbatim të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, është struktura përgjegjëse për sigurinë e shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e konsumatorit si dhe kryen veprimitari inspektuese në:

- ✓ fushën e ushqimit për kafshe me OJSH dhe OBU;

Bazuar në planin vjetor 2016 të inspektimeve *janë planifikuar* gjithsej **17.683 inspekte** dhe *janë realizuar 15443 inspekte, nga të cilat* 3496 ratse janë paralajmërimë; 159 masa administrative, si dhe 80-subjekte ndërprerje aktiviteti.

AKU, ka rritur ndjeshëm numrin e inspektimeve në kuadër të sezonit turistik dhe festave të fundvitit.

- ✓ Në fushën e ushqimit për kafshe me OSH dhe OBU;

Bazuar në planin vjetor 2016 të inspektimeve, *janë planifikuar* gjithsej **12167 inspekte**, si dhe *janë realizuar 14093 inspekte* referuar këtij plani duke përfshirë edhe inspektimet për licencim, zbatimin e urdhërave të vecantë, ankesave, alerteve të ndryshme, etj.

AKU, gjatë kontrolleve zyrtare në Operatorët e Biznesit Ushqimor, janë konstatuar disa problematika në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore si:

1. Mangësi në kushtet higjeno –sanitare;
2. Etiketimin e produkteve ushqimore dhe evidentimin i tyre me afat përdorimi të kaluar;
3. Mungesë dokumentacioni shoqërues dhe mangësi në sistemin e gjurmueshmërisë;
4. Zbatimin e kërkesave për implementimin e planit të vetëkontrollit (HACCP).

- ✓ Në fushën e mbrojtjes se bimëve dhe inuteve bujqësore.

Bazuar në raportimet frekuente të Sektorit të Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inuteve Bujqësore nga DRAKU rezulton se për vitin 2016, janë realizuar **5664 inspekte** nga të cilat:

✓ Për tregtimin e PMB-ve	1632	inspekte
✓ Për tregtimin e MMSHB-ve	1989	“
✓ Për tregtimin e Plehrave	1954	“
✓ Për tregtimin e Duhanit dhe produkteve të tij	89	“

Problematikat më kryesore të konstatuara gjatë inspektimeve të cilët bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi janë:

- ✓ Mos kryerja e analizave të PMB nga ISUV sjell mos realizimin e zërit (analizë të PMB-ve) të parashikuar në planin vjetor të inspektimeve me bazë risku dhe marries së mostrave për vitin 2016 si dhe mos evidentimin e problematikave për parametrat cilësor të tyre.
- ✓ Regjistri i shitjeve dhe blerjeve të PMB-ve “të rrezikshme” dhe me “rrezik të lart” në disa raste nuk plotësohet në vijueshmëri.
- ✓ Mungojnë Dëshmitë e Aftësisë për përdorimin e të PMB-ve “të rrezikshme” dhe me “rrezik të lartë”, të cilat jepen nga struktura e Mbrojtjes së Bimëve në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë.
- ✓ Për problemet me bazën ligjore që kanë të bëjnë me licencimin e operatoreve të biznesit për ambalazhimin e PMB-ve.
- ✓ AKU për inspektimin e subjekteve të prodhimit bujqësor të duhanit dhe tregtimin e duhanit të pa përpunuuar, si dhe tregtimin e duhanit të përpunuuar dhe i produkteve të tij nuk disponon burime njerëzore të mjaftueshme, pasi tregimi i tyre kryhet nga një numër shumë i madh subjektesh.
- ✓ Gjatë inspektimeve të kryera janë hasur probleme përsa i përket regjistrimit dhe etiketimit të plehrave.

AKU gjatë vitit 2016 ka kryer analiza për të gjitha llojet e mostrave që sillen nga inspektorët përfektivisht të kontrolleve zyrtare, ose aktivitetet e tjera të ardhura nga vetë bizneset, bazuar dhe mbështetur në metodika standarte dhe të miratuar sipas rregulloreve në fuqi dhe në përputhje me procedura të unifikuara dhe në total janë pranuar 13122 mostra dhe janë analizuar 30125 tregues analistik.

Aktualisht, *MBZHRAU, AKU* dhe *ISUV* po punojnë me asistencën e *Projektit IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit të laboratorëve të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”* (projekt i cili zgjat 36 muaj, duke filluar nga Korriku i 2016). Qëllimi është ngritja e një rrjeti kosto-eficent laboratorik të aftë për të garantuar informacion të besueshëm dhe në kohë mbi sigurinë e ushqimeve të tregtuara dhe shendetin e kafshëve. Rritja e kapaciteteve të rrjetit laboratorik për të kryer monitorime dhe analiza të produkteve ushqimore dhe ushqim per kafshe me reference specifike në fushat e monitorimit të mbetjeve të pesticideve, diagnozës mikrobiologjike në ushqim dhe ushqim për kafshë, standardeve të cilësisë, sëmundjeve të kafsheve, në përputhje me standarde të përmirësuara.

Gjithashtu AKU, kryen inspektimeve edhe në pikat e kalimit kufitar (PIK), mbështetur në Planin Kombëtar të marries së mostrave.

Për vitin 2016, referuar parashikimit të kryer në planin e kontrollit zyrtar të miratuar në total mostrat e pranuara duhet të ishin **3266** nga PIK, ndërsa faktike të realizuara janë **3140** nga importi.

Problematikat e evidentuara gjatë punës.

- Vakum në bazën ligjore egzistuese me të cilën operon Sektori i Inspektimit të Produkteve me Origjinë jo Shtazore.
- Probleme në lidhje me infrastrukturen në PIK (ambjentet e përshtatëshme për kryerjen e kontrolleve).
- Subjektet eksportuese kanë kryer procedurat doganore pa miratimin e Inspektorëve në PIK.

Nga mbikëqyrja e IQ, AKU kryen rregullisht inspekte të fushat e saj inspektuese, bazuar në vlerësimin e riskut. Dokumentacioni standard dhe listë-verifikimet janë implementuar në portal, si dhe janë trajnuar të gjithë inspektorët e AKU për përdorimin e portalit dhe janë pajisur me 130 paketa portabel, por për 2016 nuk kanë kryer inspekte online.

IQ, ka rekomanduar për AKU se për sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë ushqimore, duhet të propozojë dhe të ndryshojë disa akte nënligjore në zbatim të legjislacionit në fuqi për të tre fushat e saj inspektuese.

Për tregjet e hapura, ka mungesë kompetence ligjore dhe duhet të hartohen akte nënligjore për bashkëpunimin me pushtetin vendor.

Për kryerjen e analizave të produkteve ushqimore për të gjithë treguesit fiziko-kimikë, nuk ka standarde ushqimore të përditësuara sipas direktivave të BE, por janë qysh vitit 1989.

Në zbatim të ligjit për ushqimin dhe mbrojtjes së bimëve nuk ka përfunduar akoma, nxjerrja e disa akteve ligjore sipas Direktivave dhe standardeve të BE.

9.4 Drejtoria e Shërbimeve Veterinare, nuk ka paraqitur raportin vjetor për vitin 2016 dhe në zbatim të ligjit për inspektimin nuk ka përmbushë detyrimin ligjor të raportimit pranë Inspektoratit Qendror⁴.

Veprimtaria inspektuese në fushën e veterinarisë, kryhet nga Drejtoritë e Bujqësisë Rajonale, sektori i shërbimit veterinar. Gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese nga ana jonë, u vu re se ka patur vonesa për të përshtatur formatet standarde të inspektimit dhe për hartimin e listë-verifikimeve.

Nuk janë kryer inspekte pranë klinikave veterinare dhe mungojnë protokoll-kontrollet si akte administrative.

⁴ Neni 16, pika e) e ligjit 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH” dhe Seksioni IX, pika 3 e VKM nr. 696, datë 16.8.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përbajtjen dhe administrimin e portalit “e-inspektimi”.

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

Në zbatim të nenit 136, të ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Shërbimit Veterinar duhet të propozojë nxjerrjen e disa akteve të tjera nënligjore, të cilat janë prioritet në drejtëtim të harmonizimit të mëtejshëm ligjor në fushën e veterinarisë.

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

V. KOMENTE

Nga Raporti i vittit 2016, del qartë se inspektoratet shtetërore, gjatë këtij viti, përgjithsisht ka gjetur zbatim ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Inspektoratet shtetërore kanë përshtatur procedurën e inspektimit dhe dokumentet e inspektimit që ato përdorin me procedurën dhe dokumentet unike të inspektimit të miratuara nga Inspektorati Qendror dhe janë implementuar në sistemin e inspektimeve.

Në përgjithësi inspektoratet shtetërore ende nuk kryejnë programimin e veprimitarisë së tyre inspektuese, vjetor e mujor, në bazë të metodologjisë së vlerësimit të riskut. Në lidhje me procedurat, dokumentet e inspektimit, si dhe programinin mbi bazë rishku, në dyshim që inspektoratet shtetërore që janë mbikëqyrur nga Inspektorati Qendror, u vërejtën mangësi për të cilat janë lënë edhe rekomandimet përkatëse.

Gjatë mbikëqyrjes së veprimitarisë së inspektorateve, është vënë re se ka edhe mbivendosje të ligjeve sektoriale për fushat e inpektimit.

Konstatohet se, gjatë kësaj periudhe janë bërë përpjekje për rritjen e kapaciteteve të inspektorëve shtetërorë, të cilët janë trajnuar dhe ritrajnuar për përdorimin e sistemit on-line të inspektimit.

VI. PRAKTIKAT E MIRA

Gjatë shqyrtimit të raporteve vjetore të paraqitura nga Inspektoratet shtetërore, dhe nga analiza e veprimitarisë së Inspektoratit Qendror, në praktikat e mira mund vazhdon përsëri bashkëpunimi i mirë ndërmjet inspektorateve shtetërore të cilat ishin ngarkuar për zbatimin e ligjit nr. 76/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar. Bashkërendimi i inspektiveve të përbashkëta ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Shëndetësisë, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Inspektoratin Shtetëror të Arsimit dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, mundësoi zbatimin me efektivitet i këtij ligji nga këto inspektorate shtetërore, gjithashtu janë realizuar edhe inspektive të përbashkëta edhe për fusha të tjera inspektuese.

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

VII. MENAXHIMI FINANCIAR I INSPEKTORATIT QENDROR

000 / lekë

Në kuadër të përbushjes së gjithë aktivitetit të Inspektoratit Qendoror, buxheti i institucionit është shpenzuar për kryerjen e detyrave funksionale të këtij institucioni. Plani i buxhetit të vitit 2016, i miratuar nga Ministria e Financave, për Inspektoratin Qendoror, ka qenë 71 170 000 lekë në total dhe i detajuar sipas zërave më poshtë:

BUXHETI I VITIT 2016					
Nr.	Emerumi i zërave të shpenzimeve	Plani 2016	Fakti 2016	Diferencia Plan/Fakti	Realizimi i buxhetit %
1.	Paga, shpenzime të tjera personeli	20 000	17 208	2 792	86.04 %
2.	Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	3 500	2 645	855	75.57 %
3.	Mallra, shërbime dhe shpenzime të tje operative	8 000	7 472	528	93.40 %
4.	Investime	39 670	37 985	1 685	95.75 %
T O T A L I		71 170	65 310	5 860	91.77 %

Buxheti yjetor u realizua sipas akteve ligjore ekonomiko-financiare në fuqi për të gjitha zërat e tij.

Sic shihet dhe nga tabela e mësipërme, pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore e zë vlera e investimeve, e cila ka një peshë specifike më të lartë kundrejt totalit të shpenzimeve buxhetore, ndërsa fondi i pagave me kontributin e sigurimeve në vlerë absolute është më i vogël.

Zëri i buxhetit 231 “Investime”, i cili ishte me një vlerë totale prej 71 170 000 lekë, u realizua në masën 95.75 %. Pjesën më të madhe e zënë blerje pajisje hardware në vlerën 18 500 000 . Këto blerje Pajisje Hardware (kite portabel) shërbejnë për fuqizimin e Portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”. Zëri i dytë me peshë është shërbim i mirëmbajtjes së portalit në vlerën 9 450 000 lekë. I gjithë buxheti i miratuar për vitin 2016 u realizua në masën 91.77 %% të fondit të miratuar për t'u shpenzuar për këtë periudhë.

Inspektorati Qendoror, për vitin 2017 ka hartuar një buxhet realist, i cili do të lejojë të kryejë në kohë të gjitha aktivitetet e planifikuar, për përbushjen e misionit të tij.

VIII. REKOMANDIME

Mbi bazën e analizës së kryer mbi aktivitetin e Inspektorateve Shtetërore për vitin 2016 dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së tyre gjatë kësaj periudhe, rekomandohet si më poshtë:

- Të kryhen inspektime on-line nëpërmjet paketave portabël në sistemin unik “e-Inspektimi”, nga të gjithë inspektoratet shtetërore.
- Të hartohen nga inspektoratet shtetërore deklarata të qarta që përshkuajnë misionin e seilit prej tyre, ku të kenë fokus objektivat për mbrojtjen e interesit publik sipas fushave të tyre të inspektimit që ato mbulojnë, për përmirësimin e cilësisë së jetës së konsumatorëve.
- Të bëhet kategorizimi i subjekteve me risk më të lartë me qëllim identifikimin, parandalimin ose minimizimin e riskut, sipas udhëzimeve të Urdhrit nr. 6, datë 19.02.2015.
- Të hartohet programimi i veprimtarisë inspektuese sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut të miratuar nga Inspektorati Qendor.
- Inspektoratet Shtetërore të hartojnë treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së punës së tyre, në bashkëpunim me Inspektoratin Qendor, komunitetin shkencor/profesional të fushës së tyre të inspektimit dhe bazuar në praktikat më të mira kombëtare e ndërkombëtare.
- Të bëhet përafrimi i legjislacionit të fushave të ndryshme të inspektimit me direktivat e BE përfundimtarisë së interesit publik nëpërmjet veprimtarisë së këtyre inspektorateve, si dhe të përditësohen rregulloret e çdo inspektorati shtetëror.
- Nën koordinimin e Inspektoratit Qendor të organizohen inspektime të përbashkëta me qëllim zvogëlimin e kostos administrative ndaj subjekteve të inspektimit.
- Inspektoratet shtetërore duhet të hartojnë analiza statistikore, për të mundësuar analizimin problematikave të ndryshme, për të bërë përmirësimet e duhura. Të publikojnë të dhënat e veprimtarisë së tyre për të rritur transparencën ndaj publikut.
- Inspektorati Qendor të ushtrojë mbikëqyrje efektive mbi kryerjen e veprimtarisë së inspektimeve për të rritur përgjegjshmërinë në punë dhe performancën e inspektorëve.
- Ëbsite të përditësuara të inspektorateve shtetërore, të publikojnë broshurë për subjektet me procedurat e inspektimit dhe informacione të tjera të vlefshme për një partneritet më të mirë me subjektet inspektuese. Informimi i subjekteve dhe publikut duhet të përmirësohet më tej në mënyrë që subjektet e inspektimit që operojnë në Shqipëri dhe publiku të njojin të drejtat dhe detyrimet e tyre.

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2017

- Të bëhet informimi i biznesit nga ana e Inspektoratit Qendror rreth aktivitetit të tij si institucioni përgjegjës për rritjen e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë.
- Inspektoratet vendore nën udhëheqjen metodologjike të Inspektoratit Qendror, të përshtasin dokumentet standarde dhe të hartojnë listë -verifikimet sipas fushave të tyre të inspektimit, si dhe të jenë përdorues të sistemit të inspektimeve brenda këtij viti.

IX. KONKLUZIONE

Ecuria dhe rezultatet e reformës në inspektim do të arrihen nëpërmjet përbushjes së të gjitha objektivave të mësipërme, duke patur komunikim të vazhdueshëm ndërinstitucional me të gjithë aktorët e kësaj reforme.

Ka përfunduar përshtatja e dokumenteve standarde dhe hartimi i listë-verifikimeve për të gjithë inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese dhe janë implementuar në sistemin unik të inspektimeve “e-Inspektimi”.

Megjithë angazhimin dhe përpjekjet e Inspektoratit Qendror për kryerjen e inspektimeve online, akoma nuk gjen zbatim kjo qasje e re inovative nga të gjithë inspektoratet, e cila do të sjelle rritjen e transparencës, uljen e barrës administrative ndaj biznesit dhe reduktim të veprimeve abuzive.

Kapacitetet e burimeve njerëzore kanë nevojë akoma për përmirësim, prandaj është e domosdoshme hartimi dhe zbatimi i procedurave të trajnimit dhe certifikimit të inspektorëve.

Janë pajisur të gjithë trupa inspektuese me paketa portabël për kryerjen e inspektimeve online.

Është përditësuar regjistri kombëtar i inspektorëve shtetërore/vendore, si dhe janë pajisur me kartën e re të inspektorit shtetëror, duke evituar inspektimet e paligjshme të personave jashtë inspektorateve shtetërore.

Inspektorati Qendror duhet të rrisë rolin e vet koordinues dhe mbikëqyrës të veprimtarive të inspektimit, për të rritur sigurinë e zbatimit të ligjit të inspektimit dhe ligjeve sektoriale nga ana e inspektorateve shtetërore.